

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 3-2021

KRAHASIMI I EKONOMIVE KOSOVË-SHQIPËRI

Leuarta Maloku

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Business Commons**



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

KRAHASIMI I EKONOMIVE KOSOVË-SHQIPËRI

Shkalla Bachelor

Leuarta Maloku

Mars / 2021

Prishtinë



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti akademik 2017-2018

Leuarta Maloku

KRAHASIMI I EKONOMIVE KOSOVË-SHQIPËRI

Mentor: Prof. Ass. Dr. Enver Krasniqi

Mars\ 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

Abstrakt

Ky punim shkencor fillon me një hyrje të përgjithshme rreth ekonomive të dy vendeve të Kosovës dhe Shqipërisë, duke shpjeguar se si është e përbërë ekonomia e dy vendeve.

Pastaj tek kapitulli i dytë është paraqitur më në detaje e gjithë përbërja e ekonomive të këtyre dy shteteve. Fillimisht fillojmë me ekonominë e Kosovës, në pjesën e parë është e elaboruar gjendja e bruto produktit ndër vite i paraqitur edhe në përqindje. Gjithashtu janë të paraqitura edhe sektorët më të zhvilluar.

E njëjta vlenë edhe për vendin e dytë apo Shqipërinë. Pastaj është i paraqitur edhe krahasimi mes dy vendeve dhe bashkëpunimi mes tyre që është vërtetuar nga burime të ndryshme. Vërtetim që është i qëndrueshëm që të dyja vendet janë në stad të zhvillimit të tyre ekonomik.

Në kapitullin e tretë është i paraqitur problemi i tërë punimit që pason me pyetjen hulumtuese si vijon: *Si do të ndikonte në ekonominë e të dyja shteteve, nëse do të rritej bashkëpunimi ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës?*

Pyetje e cila shoqërohet me dy hipoteza. Në kapitullin e radhës është e paraqitur detajisht metodologjia e tërë punimit ku kemi të bëjmë më shumë me të dhëna sekondare ku është e përqendruar tek metodat empirike dhe krahasuese.

Kapitulli i pestë apo e gjithë pesha e punimit ka të bëjë me rezultatet e fituara gjatë hulumtimit, ku më së miri tregojnë shtatëgrafiket e paraqitura dhe gjithashtu me komentim apo shpjegim përkatës.

Nga hipotezat që janë parashtruar i gjithë ky punim shkencor i cili është analizuar në detaje rezulton në përputhje me HO-hipotezën negative. Të dyja shtetet duhet të bashkëpunojnë me vende më të zhvilluara dhe jo ndërmjet vete për të rritur zhvillimin ekonomik. Kapitulli i gjashtë është diskutim rreth rezultateve të fituara dhe shpjegim i gjerë të hipotezës së pranuar. Në fund janë të paraqitura referencat e punimit.

MIRËNJOHJE DHE FALËNDËRIME

Unë do të doja të fillojë të zëntime me falënderimin për të gjithë ata që më ndihmuan.

Jam mirënjohëse dhe e falënderoj mentorin e temës Prof. Dr. Enver Krasniqi, pa të cilën ky studim nuk do të ishte i mundur. Me ndikim pozitiv të udhëzimeve, mirëkuptimit, këshillave dhe motivimit nga mentori, arrita në përfundim të suksesshëm të punimit. Do të doja të shpreh falënderim për mbështetjen dhe përkrahjen e familjes time, shoqërinë time dhe kolegët e UBT – së.

PËRMBAJTJA

Abstrakt	I
MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME.....	II
HYRJE.....	1
SHQYRTIMI I LITERATURËS (HISTORIKU).....	3
Ekonomia e Kosovës	6
Ekonomia e Shqipërisë	10
Krahasimet e ekonomive të te dy shteteve	11
Bashkëpunimi ekonomik Kosovë- Shqipëri	13
2.2.3.Tregtia midis Kosovës dhe Shqipërisë	16
2.2.4. Barrierat jo-tarifore.....	17
DEKLARIMI I PROBLEMIT	20
METODOLGJIA	21
REZULTATET.....	22
Rezultati B	29
KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	31
LITERATURA.....	34

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Tregtia e jashtme e Shqipërisë 2006-2016 sipas tre grupimeve kryesore tregtare dhe Kosovës (Leartha Hollaj , 2015)	23
Figura 2: Tregtia e jashtme e Shqipërisë me vendet e rajonit 2006-2016 (Leartha Hollaj , 2015)	24
Figura 3: Ecuria e importeve dhe eksporteve dhe pesha e tregtisë me Kosovën, si pjesë e tregtisë me rajonin 2006-2016 (Leartha Hollaj , 2015)	25
Figura 4: Përqendrimi i eksporteve në tregtinë me Kosovën sipas produkteve –2016 (Leartha Hollaj , 2015)	26
Figura 5: Përqendrimi i importeve në tregtinë me Kosovën – 2016 (Leartha Hollaj , 2015)	27
Figura 6: Tregtia e Kosovës me Shqipërinë dhe pesha e saj në tregtinë me jashtë të Kosovës (Leartha Hollaj , 2015).....	28
Figura 7: Vlera mesatare e mallrave të shkëmbyera Brenda BE dhe midis Shqipërisë, BE dhe vendeve të rajonit (Leartha Hollaj , 2015)	29

HYRJE

Ekonomia e Kosovës përbën një ekonomi tërë dhe dinamike. Baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste, e dirigjuar, në një ekonomi të hapur të tregut.

Kosova ka një bilanc tregtar vazhdimisht negativ, për faktin që kërkesa e tregut plotësohet kryesisht përmes importeve përderisa në mungesë të një industrie dhe sektori të zhvilluar të prodhimit, vendi nuk arrin të përformoj kënaqshëm në aktivitetin eksportues. Në anën tjetër, Shqipëria pozicionohet më mirë në këtë aspekt. Mirëpo, përveç që është një ekonomi e përmasave relativisht më të mëdha, Shqipëria po ashtu i është nënshtruar ndër vite tashmë një deficitit të vazhdueshëm tregtar. Në këtë pikë, vlen të përmendet që dominimi i importeve në të dy vendet ndikon drejtpërdrejt në bruto prodhimin vendor dhe si pasojë në zhvillimin ekonomik të tyre. Si Kosova ashtu edhe Shqipëria, për shkak të potencialit të ulët ekonomik, nuk është se kanë një rol të rëndësishëm në tregjet evropiane apo botërore.

Qëllim në vete tashmë është rritja e konkurrencës së kësaj ekonomie, duke rritur kapacitetin esaj eksportues për të zvogëluar deficitin tregtar që Kosova aktualisht ka. Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, Kosova ofron një sërë përparësish që janë: popullsia e re dhe mjaft e kualifikuar, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-së dhe në atë të Bashkimit Evropian.

Për një sipërfaqe të vogël sa ka Shqipëria mund të thuhet se është e begatshme me pasuri natyrore. Pjesa jug-perëndimore e vendit është e pasur me naftë dhe gaz natyror. Ndërsa në veri-lindje gjenden rezerva të konsiderueshme të mineraleve ndër të cilat vlen të përmenden: kromi, bakri, hekur-nikeli. Po ashtu Shqipëria është e begatuar me lumenjtë të rrëmbyeshëm të cilët janë edhe potencial për hidrocentrale.

Ka lëvizje pozitive në trendët e bashkëpunimit ekonomik në mes të Kosovës dhe Shqipërisë por kjo situatë dhe këto raporte shumë më tepër duhet të obligojnë vendet që të avancojnë

ketë bashkëpunim dhe më tepër duke i shfrytëzuar të gjitha resurset që posedojnë të dyja shtetet.

Përmes këtij punimi kam për qëllim të paraqes ekonominë e dy shteteve si Kosova dhe Shqipëria, si ka qenë ekonomia e Kosovës dhe Shqipërisë gjatë viteve të fundit, krahasimin dhe bashkëpunimin e këtyre dy shteteve sa i përket zhvillimit ekonomik. Njëkohësisht analizimi i funksionimit të ekonomisë në Kosovë dhe i ekonomisë në Shqipëri e pastaj krahasimi mes tyre për të shikuar dallimet dhe ngjashmërit.

Qëllim i punimit është edhe analizimi i bashkëpunimit dhe ndikimi i këtij bashkëpunimi pozitiv apo negativ në këto vende. Përmes analizës empirike synohet që të arrijmë në rezultatet e duhura për përgjigjen e duhur në pyetjen tonë kërkimore/hulumtuese. Për këtë qëllim do të shfrytëzohen studimet empirike, hulumtimet shkencore e padyshim dhe literaturat bashkëkohore dhe shkencor e një spektri të gjerë që ka të bëjë me fushën e këtij punimi.

Po ashtu, janë shfrytëzuar dhe studimet e instituteve kërkimore-shkencore, raportet e institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombetare si dhe të dhënat e publikuara në internet.

Objektivat e përgjithshme të hulumtimit janë:

- Rishikimi dhe shqyrtimi i literaturës në lidhje me zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe Shqipërisë dhe funksionimi i tyre për të arritur në përfundim nëse teoritë zbatohen në praktikë,
- Analiza e faktoreve ndikues sic janë faktorët ekonomik dhe politiko-social në zhvillimin e dy vendeve,
- Analizimi i përmirësimit të shkëmbimit tregtar mes Kosovës dhe Shqipëris dhe faktorëve që kanë ndikuar në të.

SHQYRTIMI I LITERATURËS (HISTORIKU)

Jeta shoqërore është komplekse. Kompleksitetit të saj i përgjigjet kompleksiteti i shkencave shoqërore, çdo njëra prej të cilave studion anë të veçanta të jetës shoqërore, të sjelljes së individëve, grupeve shoqërore dhe institucioneve shoqërore. Ekonomiksi studion pikerisht anën ekonomike të jetës shoqërore, sjelljen e agjentëve ekonomike në shoqëri dhe kushtet ekonomike të bashkëveprimit të tyre. Në rolin e agjenteve ekonomike ose vendimmarrësve, sikurse quhen ndryshe, paraqiten individët (ose familjet), firmat dhe qeveria (Qirici, 2002).

Ekonomiksi është shkenca e alokimit (shpërndarjes) të burimeve të kufizuara ndaj nevojave konkurruese, të pakufizuara. Ekonomiksindihmon për të bërë zgjedhjen më të mirë të mundshme, zgjedhjen optimale, pra të merret vendimi, me koston më të ulët optimale (Maçellari, 2012).

Një ekonomi përfshin të gjitha aktivitetet që lidhen me prodhimin, konsumin dhe tregtinë e mallrave dhe shërbimeve në një zonë. Këto vendime merren përmes një kombinimi të transaksioneve të tregut dhe vendimmarrjes kolektive ose hierarkike. Të gjithë, nga individë të subjekteve të tilla si familjet, korporatat dhe qeveritë marrin pjesë në këtë proces. Ekonomia e një rajoni ose vendi të veçantë drejtohet nga kultura, ligjet, historia dhe gjeografia e saj, ndër faktorë të tjerë, dhe evoluon për shkak të zgjedhjeve dhe veprimeve të pjesëmarrësve. Për këtë arsye, asnjë dy ekonomi nuk janë identike (Kenton, 2009).

Rritja ekonomike i referohet një rritjeje të kapacitetit prodhues të një ekonomiesi rezultat i së cilës ekonomia është e aftë të prodhojë sasi shtesë të mallrat dhe shërbimet. Normalisht standardi ynë i jetesës matet nga sasia e mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për ne në mënyrë që rritja ekonomike të jetë sinonim i një rritjeje në standardi i përgjithshëm i jetesës (Palmer, 2012).

Në përgjithësi, ekonomia kombëtare konsiderohet e qëndrueshme nëse është e aftë të shfrytëzojë burimet dhe kapacitetet e saj njerëzore, financiare dhe kapitale, për gjenerimin e rritjes të vazhdueshme ekonomike dhe për sigurimin e mirëqenies së gjithë banorëve të saj.

Rëndësia e resurseve (njerëzore, financiare dhe natyrore) është e pakontestueshme, mirëpo vetëm shfrytëzimi efektiv i tyre siguron një rritje të vazhdueshme ekonomike dhe mirëqenie shoqërore. Rritja është esenciale për arritjen e stabilitetit socio-ekonomik dhe zhvillimin politik të një vendi. Rritja substanciale afatgjate do të siguronte ekonomi të qëndrueshme. Rritja ekonomike paraqet rritjen e produktit real të brendshëm bruto të një vendi dhe ndryshimin në kapacitetet prodhuese të vendit. Rritja nuk shfaqet rastësisht. Ajo është rezultat i politikave cilësore (produktivitetit, teknologjisë, risive dhe efekteve të jashtme).Procesi i rritjes ekonomike shoqërohet me një spektër të gjerë të politikave: financimin e zhvillimit, infrastrukturën publike, kornizën rregullative, politikat industriale, intervenimet qeveritare. Reformat serioze të orientuara kah ndërtimi i ekonomisë së bazuar në treg dhe krijimi i një stabiliteti ekonomik dhe politik janë faktorë kyç të rritjes në ekonomitë në tranzicion.

Sfidat e vendeve në zhvillim, si pjesë e një ekonomie të përfshirë nga globalizimi dhe rritja, të fokusohen kryesisht në tejkalimin e problemeve në këto fusha:

- Kursimi, përkatësisht investimet joadekuate
- Fuqia punëtore joadekuate
- Përkeqësimi i kushteve për tregtinë
- Institucionet e dobëta

Ekonomia e Kosovës dhe e Shqipërisë kanë një sfidë të përbashkët, janë ende shumë pak të integruara në ekonominë rajonale dhe evropiane (Riinvest, 2005). Politikat në lidhje me reformat e nevojshme strukturore duhet të jenë rezultat i një kornize të gjithëmbarshme analitike dhe në bazë të një strategjie zhvillimore të caktohen prioritetet. Kjo nuk është një detyrë e lehtë, duke pasur parasysh gamën e variablave që ndikojnë në standardin jetësor dhe rrjetin kompleks të ndërlikimeve përmes së cilave këto variabla e mbajnë njëra-tjetrën. Dizajnimi i një strategjie të zhvillimit ekonomik për Kosovën është edhe më

sfiduese, për shkak të mungesës së statistikave dhe periudhës së shkurtër kohore gjatë së cilës Kosova ka qëndruar si njësi e pavarur ekonomike me një organizim të ndarë institucional dhe me politikat e duhura. Çështjet e caktuara janë gjurmuar deri në një masë të madhe në shumicën e rasteve nga këshilltarë të huaj, të cilët kanë një prezencë të madhe në Kosovë. Megjithatë, ato duhet të bashkohen në një kornizë që identifikon fushat e prioriteteve që mund të qasen në mënyrë aktive. Është me rëndësi që çështjet e politikave të mos analizohen të izoluara, siç ndodh shpesh, por kjo duhet të bëhet në ndërlidhje me njëra-tjetrën dhe në mënyrë sistematike. Përcaktuesi më i afërm i zhvillimit është investimi, meqë krijon vende pune dhe prodhim. Edhe pse lidhja e supozuar e drejtpërdrejtë e investimit me ngritjen dhe zhvillimin, në një mënyrë, është diskredituar kohëve të fundit nga dëshmitë e reja empirike, megjithatë, pranohet se ngritja do të dështojë në mungesë të investimeve. Me fjalë të tjera, investimi është një kusht i domosdoshëm por jo i mjaftueshëm për ngritje (Riinvest, 2005).

Qeveritë mund të influencojnë rritjen afatgjatë, me anë të institucioneve, politikave strukturore dhe atyre stabilizuese.

Fushat kryesore më me ndikim janë:

- 1) Arsimi dhe kapitali njerëzor, si ndikues efektivë në kategori të tjera, siç janë: kapitali fizik, adoptimi i teknologjive etj.,
- 2) Intensiteti financiar, përkatësisht zhvillimi i tregjeve financiare,
- 3) Hapja ndaj tregtisë ndërkombëtare, e cila ndikon në shkallën e konkurrencës, risive teknologjike dhe në FPP,
- 4) Kufizimet buxhetore,
- 5) Cilësia e shërbimeve dhe infrastrukturës publike,
- 6) Qeverisja (kapacitetet dhe cilësia e institucioneve, kufizimi i korrupsionit, zbatueshmëria e kontratave dhe rendi e ligji).

Politikat stabilizuese kanë për qëllim krijimin e një influence dhe stabiliteti në fushën e financave, tatimeve dhe investimeve. Inflacioni i lartë dhe rreziku nga deficitin në bilancin e

pagesave, i cili ka prejardhjen nga çrregullimet në kursin valutor dhe shpesh edhe nga krizat e ndryshme bankare, paraqesin pengesë serioze për rritje. Roli i sektorit financiar është kyç në kanalizimin e kursimeve në investime. Si përfundim, mund të konstatojmë se rritja ekonomike ngrihet me përmirësimin e edukimit, intensitetin financiar, tregtinë e hapur dhe infrastrukturën e mirë publike. Ndërsa, rritja ekonomike bie me kufizimet ekstensive, kur politikat e zbatuara nuk janë në favor të stabilitetit makroekonomik (inflacioni, stërvlerësimi i kursit valutor dhe krizat në sistemin bankar), si dhe në kushtet negative të tregtisë. Kombinimi i duhur i politikave ekonomike mund të gjenerojë modelin që siguron vetëqëndrueshmëri të rritjes ekonomike (Riinvest, 2005).

Ekonomia e Kosovës

Kosova ka një ekonomi të re dhe dinamike. Baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste, e dirigjuar, në një ekonomi të hapur të tregut, cila transformimin e saj të thellë e ka përjetuar pas vitit 1999, me çlirimin e Kosovës nga Serbia. Një ndër sfidat me të cilat ajo u përball gjatë dekadës së fundit është edhe procesi i privatizimit. Gjatë vitit 2009 gjithsej 114 ndërmarrje shoqërore (NSH), të reja u shpallen për privatizim, duke ngritur kështu në 569 numrin e gjithsej NSH-ve, të tenderuat për privatizim deri në fund të vitit 2009. Nga këto për 521 ndërmarrje janë nënshkruar kontratat e shitjes, ndërsa 48 tjera priten të nënshkruhen (25 prej tyre janë privatizuar në spin-off special). E ndodhur në Evropën Juglindore, ekonomia e Kosovës është bërë pjesë e integritimeve ekonomike të këtij rajoni, të cilat ofrojnë mundësitë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaftë të gjerë. Qëllim në vete tashmë është rritja e konkurrencës së kësaj ekonomie, duke rritur kapacitetin e saj eksportues për të zvogëluar deficitin tregtarë që Kosova aktualisht ka. Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, Kosova ofron një sërë përparësish komparative si: popullsinë e re dhe mjaftë mirë të kualifikuar, ku mosha mesatare e saj është mjaftë e re, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-së dhe në atë të Bashkimit Evropian. Kosova përveç se është anëtare e CEFTA-së, në qershor të këtij viti është anëtarësuar edhe në FMN (Fondi Monetar Ndërkombëtar) dhe

BB (Banka Botërore) dhe aspiron në mekanizma tjerë të fuqishëm ekonomik-financiar si BERZH, Organizata botërore e Tregtisë (OBT) etj (Ekonomia e Kosovës, 2019).

Në vitet 2010, PBP e Kosovës ishte e barabartë me 6.7 miliardë dollarë në vit: vlera e bujqësisë ishte 774.3 milion dollarë; vlera e prodhimit ishte 725.1 milion dollarë. Meqenëse shpërndarja në botë është më pak se 0,01%, vendi klasifikohet si njëmikro ekonomi. Në vitet 2010, PBB për person ishte 3 838.8 dollarë, vlera e bujqësisë për frymë ishte 441.5 dollarë, vlera e prodhimit për person ishte 413.4 \$. Meqenëse prodhueshmëria është mesatarisht në mes së nën mesatares dhe asaj mesatares, ekonomia klasifikohet si në zhvillim. Në vitin 2010, rritja e PBP-së ishte 3.4%; rritja e bujqësisë ishte -0,45%; rritja e prodhimit ishte 3.2%. Në vitin 2010, ekonomia e Kosovës përfshinte: shërbime (34.9%), industri (20.5%), tregti (16.0%), bujqësi (14.0%), ndërtim (8.3%) dhe transport (6.4%). Në vitin 2010, importi ishte 2.3 herë më i lartë se eksporti, importi neto ishte i barabartë me 29.7% të GDP-së. Qëndrimi i riprodhimit ndaj konsumit është më i mirë se mesatarja globale, kështu që pjesa e PBP-së në botë do të rritet (Kushnir, 2019).

Historikisht, ekonomia e Kosovës gjithmonë varet nga minierat dhe bujqësia. Produktet kryesore të tij ose eksportoheshin drejtpërdrejt kryesisht në Bashkimin Sovjetik ose transferoheshin në rajone të tjera të Jugosllavisë si materiale të papërpunuara. Prandaj, Kosova kurrë nuk ka qenë një qendër kryesore e prodhimit gjatë periudhave para dhe pas Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi. Bujqësia është industria tjetër kryesore për ekonominë e Kosovës. Bujqësia ekzistenciale vazhdoi si një shtyllë kryesore e shumë ekonomive familjare.

Kosova ka të ardhurat më të ulëta për kokë banori dhe shkallën më të lartë të papunësisë krahasuar me ekonomitë fqinje dhe ato të zgjedhura në tranzicion. Ajo ka performancën më të dobët eksportuese dhe nuk mund të merret në masën e duhur e investimeve të huaja direkte (Kryeziu, 2018).

Shënimet e rregullta për ekonomin e Kosovës si duket kanë filluar të mbahen pas luftës së dytë botërore me stabilizimin e sistemit socialist jugosllav. Si do që të ketë qenë, deri para vendosjes së "masave të dhunshme" nga rrënojat e luftës së dytë botërore është ngritur një nivel i ekonomisë së një qarku të mbyllur, përkthimi i të cilit është penguar pikërisht nga ky intervenim i kompozuar me ndërhyrjen dhe trazira të tjera politike. Pika të veçuara të këtij qarku kanë qenë korporata apo siç thuhet sot kompanitë, si "Trepça", "Agro Kosova" etj. Në sektorin e ndërtimit, ndërmarrjet edhe sipërmarrjet e ndërtimit si duket nuk kanë arritur të krijojnë korporatën e tyre dhe kanë ngelur në nivel më të ultë se ajo e industrisë dhe tregtisë e industrisë ushqimore. Pas luftës, bujqësia në Kosovë ka filluar nga pika zero. Për krijimin e një sektori të bujqësisë, së pari është punuar për krijimin e institucioneve nëpërmjet të cilave është bërë koordinimi i ndihmave nga bota e jashtme. Menjëherë me krijimin e qeverisë së përkohshme ajo ka ngritur Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila merret me çështjet e bujqësisë në nivel shtetërorë.

Duke marrë parasysh që bujqësia nuk ka nevojë për ndihma dhe investime të mëdha, pasurit natyrore dhe fuqia e lirë punëtore që gjendet në Kosovë, ministria me ndihmesat nga organizatat e jashtme kanë vepruar në një plan i cili mund të ndahet në tri faza:

Faza e parë-Faza emergjente ka filluar menjëherë pas mbarimit të luftës në vitin 1999-2000. Gjatë kësaj faze popullsia është ndihmuar dhe furnizuar me mallra të importuara. Po ashtu në këtë fazë ka pasur investime të drejtpërdrejta apo materiale, ku janë ndihmuar një numër i fermerëve. Në këtë drejtim Zvicra e ka ndihmuar sektorin e bujqësisë përmes dhurimit të krerëve të lopëve qumështore, të racave evropiane. Gjatë kësaj kohe agjencia Evropiane për rindërtim e ka ndihmuar sektorin e bujqësisë përmes investimit të blerjes së farës dhe plehrave artificiale të nevojshme për rimëkëmbjen e gjendjes.

Faza e dytë-Faza e rindërtimit dhe ndërtimit institucional apo kapaciteteve institucionale. Kjo fazë ka zgjatur nga viti 2001-2005. Shumica e investimeve kanë qenë në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, përfshirë legjislaturën, trajnimet, udhëtimet studimore, seminarët e ndryshme të cilat janë parapërgatitje e stafeve qeveritare dhe stafeve tjera të

ndërrimit të qasjes ndaj këtij sektori, po edhe kriterit të shoqatave të ndryshme e ndihmës ndaj shoqatave të bujqësisë, të blegtorëve, të qumështit, mishit, veterinarëve, etj.

Faza e tretë-Faza e ardhshme (investimeve). Kjo fazë mendohet të jetë faza e përgatitjes apo përshtatjes së legjislacionit me standarde evropiane dhe plotësim të tyre para hyrjes në BE, dhe investimeve të drejtpërdrejta kapitale në ndërtimin e kapaciteteve prodhuese të bujqësisë, duke përfshirë të gjitha degët, pemëtari, perimtari, blegtori, sektorin qumështor, mishit etj(Kukaj, 2006).

Transaksionet financiare në euro kanë përkrahur stabilitetin ekonomik. Inflacioni ka qenë i ulët dhe duke filluar nga nëntori i vitit të kaluar, deflacioni ka shoqëruar normat negative të rritjes ekonomike. Stabiliteti makroekonomik, po ashtu, mbështetet nga shpenzimet e matura buxhetore (26% në anën e të hyrave dhe 28.5% e BPV në anën e shpenzimeve) dhe kreditë e matura (16 % e BPV-së). Në anën tjetër, stabiliteti makroekonomik rrezikohet seriozisht nga shpërpjesëtimet në shumë fusha kritike, siç janë ato: midis të BPV-së dhe konsumit - deficitit tregtar shumë i lartë - shpërpjesëtimi në tregun e punës - madhësia e buxhetit dhe nevojat për investime kapitale (Riinvest, 2005).

Edhe pse Kosova ka arritur disa suksese gjatë periudhës së pasluftës, në ditët e sotme ajo ballafaqohet me një normë papunësie prej 40%, me bilanc negativ tregtar të përshkruar më lart (importet mbulohen nga eksportet me 4-5%). Duke marrë parasysh se rreth 63% e popullatës janë nën moshën 30 vjeçare dhe se kapaciteti absorbues i ekonomisë është shumë i ulët, çdo vit paraqiten 25.000-30.000 punëkërkues të rinj në tregun e punës. Kjo kërkon një rritje në punësim me një normë vjetore prej rreth 6-7%. Faktori tjetër kritik është rritja e eksporteve. Pjesëmarrja e bujqësisë në BPV është vlerësuar të jetë 25%, përderisa ajo e sektorit të shërbimeve është 60%. Pjesëmarrja e tashme e industrisë në BPV është 15%. Këto shpërpjesëtime strukturore me nivelin e tashëm të produktivitetit ndikojnë në nivelin e aftësisë konkurruese dhe në vëllimin e cilësinë e ofertës së eksportit (Riinvest, 2005).

Potenciali për ngritje në fushat tradicionale është qenësor dhe bujqësia, energjia dhe minierat, të shtytura nga privatizimi, ka gjasë të jenë qenësore për të nisur makinën e

ngritjes (zhvillimit). Kosova dikur kishte një rrjet të eksportimit të prodhimeve bujqësore, tani ka një bilanc negativ në këtë sektor. Mineralet dhe energjia ishin kyç në ekonomi dhe kanë gjeneruar një shumë të rëndësishme të ardhurave, si dhe kanë krijuar shumë vende pune. Për shkak të pranisë së resurseve dhe, në veçanti, për shkak të lehtësirave të nxjerrjes së linjtit, Kosova ka një përparësi krahasuese në miniera dhe energji. Me “zbulimin e aktiviteteve të reja” nuk nënkuptohen patjetër zbulimet dhe risitë, por edhe adoptimi fitimprurës i teknologjive të vendeve të tjera. Duke marrë parasysh shkathtësitë e tyre të kufizuara, hulumtimet e pakta dhe buxhetin zhvillimor, vendet si Kosova kanë pak hapësirë për risi dhe zbulime. Nëse një teknologji kryen punë në një vend, nuk ka garanci se do të kryejë punë në mënyrë të dobishme edhe në vendet e tjera. Adoptimi i teknologjisë është po aq i dobishëm dhe ka po aq rrezik sa edhe zbulimet e reja.

Ekonomia e Shqipërisë

Shqipëria ka një nga standardet më të ulëta të jetesës në Evropë. Përafërsisht 60% e fuqisë punëtore është e angazhuar në bujqësi; bilanci është i përfshirë në shërbime ose industri. Ekonomia e vendit u kontraktua në fillim të viteve 1990 ndërsa Shqipëria u përpoq të kalonte shpejt nga një sistem i kontrolluar nga shteti drejt një ekonomie tregtare. Gjatë kësaj periudhe, shkalla e papunësisë ishte rreth 40%, por deri në fund të dekadës ishte afër 20%. Bujqësia dikur ishte e socializuar në formën e fermave kolektive dhe shtetërore, por deri në vitin 1992 shumica e tokave bujqësore ishin privatizuar. Drithërat (sidomos gruri dhe misri), patatet, perimet, frutat dhe panxhari i sheqerit rriten dhe rriten bagëtitë. Shqipëria është e pasur me burime minerale, veçanërisht naftë, gaz natyror, qymyr, boksit, kromit, bakër, xeherore hekuri, nikel dhe kripë. Përpunimi bujqësor, nafta, minierat dhe prodhimi i tekstilit, veshjeve, lëndëve të drurit, çimentos dhe kimikateve janë ndër industritë kryesore. Fabrikat e hekurit dhe çelikut janë zhvilluar, dhe vendi ka disa stacione hidroelektrike. Për shkak të trazirave ekonomike gjatë viteve 1990, Shqipëria mbetet në thelb një vend në zhvillim. Tregtia e jashtme kryhet nga deti, Durrësi dhe Vlora (gjithashtu terminali i tubacionit të naftës) duke qenë portet kryesore. Shqipëria eksporton tekstil dhe këpucë, burime natyrore të minuara, produkte ushqimore dhe duhan dhe importon kryesisht makineritë, produktet e tjera industriale dhe mallra tjera të konsumit. Partnerët kryesorë të

saj janë Italia dhe Greqia. Në fillim të viteve 1990. Shqipëria u bashkua me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore (E.P.Stickney, 2018).

Historia e ekonomisë shqiptare na tregon se ne nuk kemi ditur me qartësi rreth faktorëve ndikues (zhvilluese dhe pengesë) ndaj rritjes ekonomike afatgjatë. Në disa periudha historike është ngatërruar situata aktuale ekonomike me përfytyrimin e ekonomisë për të ardhmen. Nisur nga kombinime të tilla ka ndodhur si pasojë një seri modelesh zhvillimi ekonomik me nivele dhe orientime të ndryshme.

Sipas statistikave të Fondit Monetar (WorldEconomic Outlook), rritja ekonomike paraqitet në nivele të ndryshme në vende të ndryshme. Ndërsa vendet e zhvilluara ekonomike kanë një rritje ekonomike në nivele të ulëta, vendet në zhvillim ekonomik kanë një nivel të lartë rritje. Por, ky fakt nuk tregon se niveli i lartë i rritjes është më i mirë se niveli i ulët, pasi vendet kanë histori të ndryshme të ekonomisë dhe ritme të ndryshme të zhvillimit të saj.

Është fakt, që për periudhën 2002 - 2012, rritja ekonomike botërore (sipas Indexmundi) është ngadalësuar paksa me një tendencë mesatare rritje në nivelin 3.2%. Ndërsa rritja ekonomike mesatare e Shqipërisë përgjatë po të njëjtës periudhë është me një rritje mesatare në nivelin 4.5%. Në gjysmën e parë të periudhës ka pasur një tendencë mesatare rritje 5.8%. Në gjysmën e dytë të periudhës rritja është ngadalësuar (veçanërisht pas vitit 2008) me një tendencë rritje mesatare 3.2%. Por, arsyet nuk janë ato që kanë vendet e zhvilluara ekonomike (Altax, 2015).

Krahasimet e ekonomive të te dy shteteve

Faktorët zhvilluese (ekonomikë dhe politiko-socialë)

Burimet natyrore minerare dhe energjetike, si dhe një sistem agro-bujqësor e blegtoral i zhvilluar janë elementët që përfshihen te ky faktor mjaft i rëndësishëm për Shqipërinë. Burimet natyrore të kombinuara me pozicionin gjeografik dhe faktorët e tjerë zhvilluese i japin ekonomisë frymëmarrjen e duhur për zhvillimin me kosto të ulët.

Investimet në zhvillimin e aktiveve afatgjata, (infrastruktura, zhvillim industrish) janë një faktor afatgjatë për zhvillim, pasi ulin koston e aktiviteteve ekonomike. Bashkëlidhur zhvillimit të industrisë nuk duhet ndaluar asnjëherë faktori i zhvillimit teknologjik të orientuar nga programet qeverisëse. Është akumulimi dhe formimi i kapitalit që rrit produktivitetin industrial, të bashkëshoqëruar me fuqi punëtore me aftësi të larta në drejtim të përdorimit të saj. Roli më i madh i mbetet investitorëve të huaj, por pa nënvlerësuar investitorët brenda vendit, që duhet të ndiejnë hapjen e ekonomisë.

Rritja e sasisë dhe cilësisë (vlerës) së fuqisë punëtore (kapitali njerëzor) dhe specifikisht ajo pjesë që investohet në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e cilësisë.

Të dy vendet janë në stad të zhvillimit të tyre ekonomik, mirëpo sektori i prodhimit në të dy vendet ngelet ende i pazhvilluar. Arsyet për një ngecje në këtë drejtim janë te shumta.

Mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe financiare, si dhe kushtet jo të volitshme për tërheqjen e investimeve në vend, kanë ndikuar në performancë të dobët të vendit në këtë drejtim. Në mënyrë që të rritet niveli i tregtisë si dhe kualiteti i shkëmbimeve tregtare, është e domosdoshme të investohet në drejtim të rivitalizimit të sektorit prodhues në vend, e që ka mbetur i pazhvilluar nga paslufta. Politikat fiskale paraqesin një pengesë të vazhdueshme për prodhuesit vendorë, përderisa mungesa e subvencioneve të ndryshme shihet si një problem tjetër me ndikim të dukshëm në kapacitetet prodhuese në vend. Mirëpo ajo që ndikon dukshëm në zhvillimin dhe potencialin për zhvillim të marrëdhënieve ekonomike në mes të dy vendeve është pikërisht madhësia e vogël e tregjeve respektuese.

Përkundër vullnetit dhe dëshirës për të përmirësuar marrëdhëniet me njëri tjetrin, tregtia në mes Kosovës dhe Shqipërisë ka qenë preh e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve të shumta në vitet e fundit. Ajo që vlen të theksohet është një përkushtim më intensive si i nivelit qeveritar po ashtu edhe i komunitetit biznesor për të luftuar këto barrierë jo tarifore dhe për të gjetur modalitete për zgjidhjen e problemit.

Përderisa zëra të ndryshëm thërrasin për krijimin e një tregu të përbashkët ekonomik, ajo që shihet si më e arsyeshme në këto rrethana është që të dyja palët të fokusohen në respektimin

dhe jetësimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe ti përkushtohen përpilimit të strategjive dhe planeve të veprimit të detajuara që do të shpjen natyrshëm te arritja e lirit të tregut dhe rrjedhimisht do të përmirësonin bilancin tregtar në mes të dy vendeve. Në shkëmbimet tregtare bilaterale, dominojnë metalet dhe lëndët bazë, ku Kosova eksporton kryesisht skrap, përderisa merr nga eksportet e Shqipërisë të destinuara për Kosovë hekur për sektorin e ndërtimit. Importi i Shqipërisë nga Kosova zë afërsisht 1% të importit të saj total, ndërsa eksporti zë afërsisht 8,15% të totalit. Kurse për Kosovën importi nga Shqipëria zë afërsisht 3,9% të totalit të saj të portofolios së importit, ndërsa eksporti zë afërsisht 10,8% të totalit. Në vitin 2004, në Kosovë janë regjistruar 23 biznese Shqipëtare, kryesisht në sektorin e ndërtimitarisë si dhe kemi një risi të bizneseve të fokusuara në sektorin e barnave, ndërsa në Shqipëri prezenca e bizneseve kosovare është përgjithësisht më e ultë dhe kryesisht kemi të bëjmë me biznese mikro dhe të vogla.

Dallimet më të shquara në mes të dy vendeve janë në sistemet fiskale respektive të aplikuara në territoret e tyre. Përkrah dallimeve në shkallën e TVSH-së, e cila në Shqipëri është 20% e në Kosovë është 16%, ka dallime edhe në bazë të taksueshme.

Po ashtu, duke filluar nga 1 janari 2014, Shqipëria aplikon taksë progresive për tatimin mbi fitim dhe të ardhura, përderisa në Kosovë aplikohet sistemi i taksës gjysmë progresive në funksion të tavanit. Për më tepër, të dy vendet kanë të ndërtuar sistemin ligjor i cili është i përshtatur për nevojat individuale, por që kurrësi nuk kontribuon drejt asaj që këto dy vende të kenë më të lehtë bashkëveprimin e tyre në fushën e tregtisë.

Dallimet e llojit të tillë në mes të dy vendeve e vështirësojnë edhe më tutje mundësinë e bashkëpunimit tregtar në një nivel më të hovshëm (Learta, 2015).

Bashkëpunimi ekonomik Kosovë - Shqipëri

Diskutimi për krijimin e një hapësire ekonomike të përbashkët Kosovë-Shqipëri është mjaft i gjerë, ai fillon nga nevojat e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara deri tani nga dy vendet, vazhdon me programimin e avancimit drejt një tregu të përbashkët që do të

garantonte lëvizjen e lirë të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitaleve, të karakterizuara nga një tarifë doganore unike kundrejt të tretëve, si dhe përfshin diskutimin e alternativave të intensifikimit të mëtejshëm të bashkëpunimit drejt një tregu unik, ku politikat ekonomike të dy shteteve do të konvergjonin. Kuadri i këtij diskutimi mbështetet në kontekstin institucional ekzistues të iniciativave bilaterale, atyre rajonale, të OBT dhe mbi të gjitha, në kuadrin e procesit të anëtarësimit të dy vendeve në Bashkimin Evropian.

Gjatë dhjetë viteve të fundit Shqipëria dhe Kosova karakterizohen nga një rritje ekonomike relativisht e lartë, e shoqëruar me një inflacion të mbajtur nën kontroll.

Në vitin 2012, Shqipëria raporton 13.6% të papunë, ndërsa Kosova 44.8%.

Shkëmbimet tregtare vuajnë nga një deficit tregtar strukturor shumë i lartë, me eksportet anemike kryesisht në lëndën të parë me vlerë të shtuar të ulët dhe importet që mbulojnë dhe produktet bazë. Bilanci i pagesave ekuilibrohet nga remitancat dhe kohët e fundit në Shqipëri nga borxhmarrja. Investimet e huaja janë në rënie në Shqipëri edhe në Kosovë.

Në Kosovë operojnë 502 biznese Shqiptare, kryesisht në ndërtim dhe financë, ndërsa në Shqipëri 386 biznese kosovare, kryesisht mikro dhe të vogla.

Në shkëmbimet tregtare dominojnë metalet, ku Kosova eksporton hekur mbeturinë (skrap), si dhe një sasi të vogël të gypave të metalit, ndërsa importon hekur për ndërtim.

Importi i Shqipërisë nga Kosova zë afërsisht 0,97% të importit total, ndërsa eksporti zë afërsisht 8,15% të totalit. Kurse për Kosovën importinga Shqipëria zë afërsisht 3,9% të totalit të saj të importit, ndërsa eksporti zë afërsisht 10,8% të totalit të saj të eksportuar.

Objektivi për krijimin e një zone ekonomike mes Kosovës dhe Shqipërisë duhet të konsiderohet si një përparësi në aspektin ekonomik të dyja vendeve.

Ekonomitë e Kosovës dhe Shqipërisë do të përfitonin nga shfrytëzimi i përbashkët i aseteve më të rëndësishëm ekonomike të shtrirë në të dy anët e kufirit. Në këtë drejtim, bujqësia, peshkimi dhe pasuritë minerale mund të luanin një rol vendimtar.

Për arritjen e një rritje të qëndrueshme ekonomike, e cila do shkaktonte krijimin e mundësive të reja të punësimit, ekonomitë e Kosovës dhe Shqipërisë duhet ti drejtohen më shumë prodhimit. Në këtë kontekst, krijimi i një politike të përbashkët për tregun e energjisë është e domosdoshme. Aktualisht ‘Sistemi Energjetik i Shqipërisë’ bazohet kryesisht në energjinë e prodhuar nga hidrocentralet në veri të vendit, ndërsa energjia elektrike në Kosovë prodhohet nga termocentralet. Në të dyja vendet, sektori i energjisë elektrike mbështetet ekskluzivisht në shfrytëzimin e resurseve natyrore, burimet hidroenergjetike në Shqipërisë dhe rezervat e linjitet në Kosovë.

Në Shqipëri, prodhimi i energjisë elektrike varet ngushtësisht nga sasia e reshjeve që bien në kaskadën e lumit Drin dhe gjatë sezoneve të thata, furnizimi me energji elektrike ka qenë shpeshherë i mangët, në këtë prizëm, sektorët e energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës do të mund të bëhen komplementare për njëri tjetrin.

Termocentralet e Kosovës mund të furnizonin Shqipërinë gjatë verës dhe hidrocentralet shqiptare mund të furnizonin rrjetin elektrik të Kosovës gjatë vjeshtës dhe dimrit (Rexhepi, 2013).

Shkëmbimet tregtare Shqipëri-Kosovë janë rritur ndjeshëm sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Volumi i shkëmbimeve tregtare mes Shqipërisë dhe Kosovës gjatë vitit 2018, në vlerën 36 miliardë Lekë (295 milionë Euro), përfaqëson 3.8% të volumit tregtar total të Shqipërisë, ndërkohë që norma mesatare vjetore e rritjes së shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve për 5 vitet e fundit vlerësohet në 11%. Pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve e zënë eksportet e Shqipërisë drejt Kosovës, të cilat përfaqësuan 75% të volumit tregtar në 2018, në vlerën prej 27 miliardë lekë (222 milionë Euro). Importet e Shqipërisë nga Kosova vlerësohen në rreth 9 miliardë lekë, duke qëndruar 3 herë më të ulëta se eksportet. Ritmi mesatar vjetor i rritjes së importeve është i ngjashëm me atë të eksporteve dhe vlerësohet në 12%. Eksportet ngelen me dinamikë dhe volatilitet më të lartë nga viti në vit krahasuar me fluksin e importeve. Në flukset tregtare midis dy vendeve në përgjithësi, vihet re mungesa e qëndrueshmërisë.

Shkëmbimet ekonomike mes dy vendeve janë shumë më të gjera se vetëm flukset tregtare. Ato shtrihen në shkëmbime ekonomike në industrinë e turizmit, shërbimeve financiare, shkëmbime në fushën e arsimit dhe teknologjisë, transportit apo telekomunikacionit. Vetëm gjatë 2018, Investimet e Huaja Direkte (IHD) me origjinë nga Shqipëria drejt Kosovës u vlerësuan në 22.3 milion euro, duke renditur Shqipërinë ndër investitorët më të rëndësishëm për Kosovën.

Integrimi i tregjeve të punës mes dy vendeve vazhdon të mbetet modest si rezultat i papunësisë së lartë dhe diferencës së ulët të pagave mesatare mes dy vendeve. Në lëvizjen e ulët të krahut të punës mes dy vendeve kanë ndikuar dhe pengesa administrative si procedurat e lejeve për punë apo ato të njohjes reciproke të kualifikimeve, pengesa që po tentohet të adresohen në kuadrin e nxitjes së bashkëpunimit mes dy vendeve. Integrimi i sistemit arsimor, sidomos i arsimit të lartë, njohjes reciproke të programeve të studimit dhe profesioneve është gjithashtu një faktor që nuk ndihmon shkëmbimet e tregut të punës. Të huajt që qëndrojnë në Shqipëri për qëllime punësimi, përfaqësojnë një raport mjaft të vogël të të punësuarve, vetëm 0.5% të të punësuarve. Ndër të huajt që vijnë për të punuar në Shqipëri, 11% janë me origjinë nga Kosova.

2.2.3.Tregtia midis Kosovës dhe Shqipërisë

Eksportet e Shqipërisë në Kosovë:

Dinamika dhe struktura Shqipëria eksportoi në tregun global, në vitin 2018, mallra në vlerën prej 310 miliardë lekë, me rritje vjetore të eksportit në masën 14% (krahasuar me 2017). Eksportet Shqipëtare janë të orientuara kryesisht drejt tregut evropian, në të cilin u eksportuan 79% e totalit, me vlerë 244 miliardë lekë. Eksportet drejt Ballkanit Perëndimor janë duke rritur gradualisht peshën relative ndaj totalit të eksporteve, duke pasqyruar rritjen e rëndësisë të rajonit kundrejt vendeve të tjera të botës. Eksportet drejt rajonit janë në masën më të madhe me destinacion tregun e Kosovës; pothuajse gjysma e eksporteve rajonale të Shqipërisë orientohet drejt Kosovës. Eksportet e Shqipërisë drejt Kosovës, në 2018, përfaqësuan 9% të volumit të eksporteve totale, duke arritur vlerën prej 27,093 milionë lekë (222 milionë Euro). Eksportet raportohen të jenë 29% më të larta në 2018, krahasuar me

2017, një normë rritjeje dy herë më e lartë se norma e rritjes së eksporteve në nivel kombëtar.

2.2.4. Barrierat jo-tarifore

Analiza e zhvillimit të marrdhënieve ekonomike dhe tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës, e parë nga aspekti i barrierave teknike dhe jotarifore të lëvizjes së mallrave përmbledh problematikën në dy kategori kryesore: (1) çështje të lidhura me cilësinë, të tilla si njohja reciproke e certifikatave, infrastruktura jo e përshtatshme e testimeve, etj., (2) çështje që lidhen me lehtësimin e tregtisë, të tilla si kompleksiteti i praktikave të zhdoganimeve, inspektimet e shpeshta, kohëzgjatja e pëmbjlljes së transaksioneve, etj., të cilat rrisin kostot dhe dëmtojnë konkurrueshmërinë e biznesve prodhuese në të dy anët e kufirit. Duhet theksuar se këto çështje nuk janë problem ekskluzivisht vetëm në praktikën tregtare midis dy vendeve, pasi ato ndeshën në të gjithë praktikën e tregtisë me jashtë në përgjithësi. Duke qenë se midis Shqipërisë dhe Kosovës ka një kuadër institucional më të favorizuar se me vendet e tjera, ne kemi përpjekur të diferencojmë këto praktika që përmendëm më sipër, në rastet kur ka të tilla. Marrdhëniet ekonomike dhe tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës janë të kornizuara si nga angazhimet e përbashkëta që dy vendet kanë ndërmarrë në kuadër të CEFTA, por edhe nga një numër gjithnjë në rritje marrëveshjesh dypalëshe që janë nënshkruar që prej vitit 2003, dhe që kanë marrë një hov më të madh pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 (raportohen gjithsej rreth 50 të tilla). Ndërkohë që liberalizimi i tarifave doganore është arritur pa probleme, në shkëmbimet tregtare mes dy vendeve mbeten barrierat jotarifore dhe ato teknike. Ato kanë qenë dhe burime të konflikteve tregtare midis dy vendeve. Në thelb konfliktet nuk janë krijuar nga masa diskriminuese të zbatuara ekskluzivisht ndaj njëri-tjetrit, por ato janë zbatuar me të gjithë vendeve të tjera. Për shembull, vendosja e akcizës së diferencuar nga Shqipëria mbi prodhimet alkoolike (birrë, verë) për prodhuesit me kapacitet mbi 1 milion litër, në thelb synon të mbrojë prodhuesit vendas të cilët janë përgjithësisht më të vegjël se prodhuesit e huaj, prej të cilëve importohen sasi të mëdha në Shqipëri. Por, kjo masë e cila aplikohet nga Shqipëria ndaj të gjithë importeve të këtyre produkteve nga jashtë vendit, preku edhe tre subjekte prodhuese nga Kosova të cilët dispononin kapacitete prodhuese mbi

1 milion litër në vit. Duhet theksuar se praktika e aplikimit të një akcize të diferencuar për prodhuesit e vegjël është në linjë me praktikën e vendeve të BE-së, 1) marrëdhëniet me konflikte kulmuan në vitin 2013, kur u përfshinë edhe autoritetet shtetërore të dy vendeve, 2) . Për herë të parë që nga viti 1999, marrëdhëniet tregtare shënuan rënie në atë vit, për shkak se, bllokimi i qumështit shqiptar në tregjet e Kosovës u ndoq me bllokimin nga pala shqiptare të importit të mishit dhe të miellit nga Kosova. Më tej, konflikti vijoi nga pala e Kosovës me bllokimin e materialeve të ndërtimit. Gjatë verës së vitit 2013, qeveria e Kosovës zhvendosi pikat e zhdoganimit të mallrave, duke krijuar probleme për eksportuesit e Shqipërisë.(Acit, 2020)

Tregtia si nocion karakterizohet me potencialin që ka për të krijuar partneritete profitabile dhe stabilitet në përgjithësi. Mbi të gjitha, tregtia është bazë e zhvillimit ekonomik të çdo vendi, përderisa tregtia e lirë dhe pa barriera mundëson që vendet të specializojnë në prodhimin e asaj që e bëjnë më mirë dhe ofron mundësinë e krijimit të ekonomisë së shkallës. Fundja, në bazë të këtyre parimeve është krijuar edhe Bashkimi Evropian, një institucion drejt së cilit aspirojnë të dy vendet. Fatmirësisht, Shqipëria dhe Kosova nuk ballafaqohen me nevojën për të investuar në ndërtimin e marrëdhënieve të mirëfillta dhe të qëndrueshme ekonomike, pasi që një gjë e tillë është realitet, duke mos anashkaluar këtu vlerat e përbashkëta shoqërore dhe kulturore, si dhe konsensusin e gjerë në nivele të ndryshme sektoriale dhe politike në të dyja anët e kufirit. Duke pas një avantazh të tillë, fokusi i të dy qeverive dhe të dyja palëve duhet të jetë përkushtimi drejt realizimit të studimeve të përbashkëta të potencialit ekonomik dhe identifikimi i faktorëve ekonomik komplementar, të cilat përfundimisht nuk do të ngeleshin vetëm dokumente të shkruara për hirë të krijimit të një atraksioni mediatik, mirëpo do të sillnin në të vërtetë një avancim të matshëm dhe të prekshëm në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare në mes të dy vendeve. Në raportet tregtare në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, vend të veçantë zë kontributi dhe përkushtimi i udhëheqësve dhe politik bërësve të të dy vendeve. Kjo kurrsesi nuk duhet të lë në hije përkushtimin e bizneseve në të dyja anët e kufirit për të aspiruar drejt përmirësimit të bashkëpunimit dhe krijimit të partneriteteve në nivel ndërshtetëror. Fatkeqësisht, deri më tani, as njëra dhe as tjetra palë nuk është se kanë shënuar progres të ndjeshëm në këtë drejtim. Rritja ekonomike e Shqipërisë dhe Kosovës

është relativisht e kënaqshme, ku vlen të përmendet fakti që të dy vendet kanë arritur të mbajnë inflacionin nën kontroll. Në shkëmbimet tregtare bilaterale, dominojnë metalet dhe lëndët bazë, ku Kosova eksporton kryesisht skrap, përderisa merr nga eksportet e Shqipërisë të destinuara për Kosovë hekur për sektorin e ndërtimit. Importi i Shqipërisë nga Kosova zë afërsisht 1% të importit të saj total, ndërsa eksporti zë afërsisht 8,15% të totalit. Kurse për Kosovën importi nga Shqipëria zë afërsisht 3,9% të totalit të saj të portfolios së importit, ndërsa eksporti zë afërsisht 10,8% të totalit. Për më tepër, të dy vendet kanë të ndërtuar sistemin ligjor i cili është i përshtatur për nevojat individuale, por që kurrsesi nuk kontribuon drejt asaj që këto dy vende të kenë më të lehtë bashkëveprimin e tyre në fushën e tregtisë. Dallimet e llojit të tillë në mes të dy vendeve e vështirësojnë edhe më tutje mundësinë e bashkëpunimit tregtar në një nivel më të hovshëm. Duke iu rikthyer edhe njëherë faktit që të dyja vendet janë vende që individualisht nuk është se paraqesin fuqi të mëdha dhe të rëndësishme ekonomike, si dhe duke marrë shkasë nga efektet pozitive të promovimit të tregtisë së lirë(Hollaj, 2015)

DEKLARIMI I PROBLEMIT

Qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës janë angazhuar vazhdimisht për forcimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve. Një seri marrëveshesh me fokus bashkëpunimi ekonomik janë nënshkruar, duke filluar nga çështjet teknike të tilla si ndihma e ndërsjellë në çështjet doganore e deri tek një partneritet më strategjik. Për sa i përket marrëdhënieve tregtare, Shqipëria dhe Kosova nuk kanë një marrëveshje specifike të tregtisë së lirë midis njëri-tjetrit. Pavarësisht nga përpjekjet dhe dokumentet e firmosura nga të dyja qeveritë, të dhënat tregojnë se volumi dhe vlera e këtyre shkëmbimeve midis dy vende janë akoma të ulëta dhe jo të qëndrueshme përgjatë viteve.

Analiza e ndikimit të politikave ekonomike të Shqipërisë dhe Kosovës është një sfidë më vete dhe e vështirë. Si rrjedhojë, do të ishte e nevojshme të shqyrtojmë marrëdhëniet tregtare. Fokusi do të jetë tek treguesit kryesorë makroekonomikë siç janë eksportet, importet, volumet e tregtisë dhe bilanci tregtar, tregtia sipas grupeve të mallrave, si dhe investimet direkte, numri i bizneseve dhe numri i vizitorëve që hyjnë në Shqipëri. Këta tregues do të ndihmojnë në analizimin e trendëve të shkëmbimeve ekonomike përgjatë viteve dhe të evidentojnë sa të jetë e mundur përfituesit e këtyre shkëmbimeve tregtare. Duke u fokusuar në volumet e tregtisë sipas grupeve të mallrave dhe duke analizuar aktivitetet ekonomike në Shqipëri dhe Kosovë, mund të vlerësohen ndikimet e mundshme në mirëqenien e tyre.

Si do të ndikonte në ekonominë e të dyja shteteve, nëse do të rritej bashkëpunimi ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës?

HA:Bashkëpunimi ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës do të shërbente si fenomen që do të ndihmonte zhvillimin ekonomik.

HO:Të dyja shtetet duhet të bashkëpunojnë me vende më të zhvilluara dhe jo ndërmjet vete për të rritur zhvillimin ekonomik.

METODOLGJIA

Metodologjia e kërkimit përfshin mbledhjen e të dhënave relevante nga metoda të ndryshme kërkimore dhe përpilimin e bazave të dhënave në mënyrë që të analizohen të dhënat dhe të arrihet ndërtim i duhur i projektit hulumtues.

Besojmë se metodologjitë e aplikuara, do t'i përgjigjen arritjes së qëllimeve të këtij punimi. Metodologjia e punimit është e bazuar në përdorimin e metodës sekondare, tek kjo metodë janë të paraqitura edhe metodat krahasuese dhe empirike në mes Kosovës dhe Shqipërisë në periudha të caktuara.

Gjithashtu është përdorur metoda historike, për të treguar rreth historisë ekonomike të këtyre dy shteteve dhe metodën statistikore sepse do të shihet edhe numri i zhvillimit ekonomik në përgjithësi të këtyre shteteve ndër vite.

Të dhënat sekondare bazohen në hulumtimin e literaturës nga autorë dhe njohës vendor e të huaj, revistave akademike dhe dokumenteve të publikuara në internet.

Duke i shfrytëzuar këto materiale të botuara të mentorëve përkatës të ekonomisë së Kosovës dhe Shqipërisë të cilët në mënyrë thelbësore janë marrë më parë me këtë studim. Nëpërmjet të cilave do të jemi të pasuruar me njohuri rreth ekonomisë së Kosovës dhe Shqipërisë, krahasimin e këtyre dy ekonomive të dy shteteve dhe bashkëpunimin ekonomik ndërmjet tyre.

REZULTATET

Në këtë kapitull do të diskutohen të gjitha rezultatet e fituara nga literatura e shqyrtuar.

Duke e ditur se ekonomia është shkenca që studion mënyrën sesi shoqëria organizon burimet ekonomike relativisht të kufizuara, për të prodhuar mallra dhe shërbime në funksion të maksimizimit të mirëqenies së njerëzve dhe duke u bazuar në interesimin që të dimë më shumë rreth ekonomisë së vendit në të cilin jetojmë është Kosova dhe vendit të cilin e cilësojmë si vëllazëror Shqipërisë, kam zgjedhur si rast studimi këto dy shtete.

Viti 2016 shënoi plotësimin e një dekade të funksionimit të marrëveshjes së tregtisë së lirë CEFTA midis vendeve të rajonit të Evropës Juglindore, që vijoi procesin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar midis vendeve, nisur në fund të viteve '90' dhe konkretizuar në marrëveshje bilaterale bashkëpunimi dhe tregtie të lirë. Kosova dhe Shqipëria janë pjesë e rëndësishme dhe aktive e këtij procesi, duke kontribuar pozitivisht në drejtim të suksesit të tij. Synimi kryesor i këtij punimi është paraqitja e përmbledhur e faktorëve të mësipërm, duke u fokusuar në marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës, përgjatë shtrirjes në kohë të CEFTA-s në periudhën 2006-2016.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, tregtia në mallra me jashtë e Shqipërisë është rritur me ritme të kënaqshme, prej mesatarisht 9.1 % në vit, kështu eksportet kanë pasur rritje mesatare vjetore më të shpejtë prej 12.1% dhe peshë më të ulët në shkëmbimet tregtare (rreth 29.6% gjatë 2016), ndërsa importet, rritje rreth 6.8% dhe peshën kryesore të tregtisë në mallra (rreth 70.4% gjatë 2016). Që prej viteve '90, Bashkimi Evropian ka qenë dhe mbetet partneri kryesor tregtar i Shqipërisë. Tregtia me Bashkimin Evropian sot përbën 67% ose 2/3 e tregtisë së jashtme të Shqipërisë, me një ulje të lehtë nga 71% e tregtisë që ajo përbënte 10 vite më parë. Rreth 1/3 e tregtisë me Bashkimin Evropian, përbëhet nga eksportet, të cilat janë rritur mesatarisht 10.6% në vit gjatë 10 viteve të fundit, ndërsa importet zënë 66% të tregtisë me Bashkimin Evropian, dhe ato janë rritur mesatarisht prej rreth 6.2% në vit. Italia, Gjermania dhe Greqia janë partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë

nga Bashkimi Evropian, pasi 76.6% e tregtisë me BE-në gjatë vitit 2016 ishte e përqendruar vetëm me këto tri shtete.

Ulja relative e peshës së tregtisë me Bashkimin Evropian gjatë 10 viteve të fundit (nga 71% në 67%) është kompensuar kryesisht nga thellimi më i shpejtë i marrëdhënieve tregtare me vendet e rajonit, përfshirë Kosovën. Si rezultat i një klime më bashkëpunuese në rajon dhe falë funksionimit të marrëveshjes së tregtisë së lirë CEFTA, tregtia me Kosovën sot përbën 2.7% të tregtisë së jashtme të Shqipërisë, nga vetëm 1.1% që ajo ishte në vitin 2006, ndërsa tregtia me vendet e tjera të rajonit (Mali i Zi, Maqedoni, Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë) përbën mbi 5% të tregtisë së jashtme të Shqipërisë, gjithashtu me rritje relative në peshën e tregtisë së jashtme prej vitit 2006.




Figura1: Tregtia e jashtme e Shqipërisë 2006-2016 sipas tre grupimeve kryesore tregtare dhe Kosovës (Learta, 2015)

Ky grafik paraqet në mënyrë të përmblodhur këtë evolucion të tregtisë së jashtme të Shqipërisë gjatë periudhës 2006-2016, në total, sipas tre grupimeve kryesore tregtare të përmendura më sipër, si dhe veçmas për Kosovën. Grafiku gjithashtu paraqet edhe tendencën e rritjes së eksporteve dhe importeve përkatëse, shprehur sipas rritjes mesatare vjetore të tyre përgjatë dimensionit horizontal për eksportet, si dhe atij vertikal për importet. Grafiku dëshmon se rritja e tregtisë së jashtme të Shqipërisë me Kosovën ka qenë

e lartë në të dy dimensionet e saj, si në eksporte (ritja mesatare vjetore 19%), ashtu edhe në importe (ritja mesatare vjetore 15.3%), e madje në rastin e importeve prej Kosovës, ritmi mesatar vjetor i rritjes ka qenë më i lartë se i njëjti tregues për tre grupimet kryesore të partnerëve tregtare të Shqipërisë.

Ndërkohë importet nga rajoni për të njëjtën periudhë janë rritur në masë të ndryshme: në nivel të ulët me Maqedoninë dhe Kroacinë, të lartë me Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën, dhe mesatarisht mbi 20% në vit me Serbinë dhe Malin e Zi. Dy shtetet e fundit të rajonit, së bashku me Kosovën, janë pikërisht ato që kanë thelluar tregtinë me Shqipërinë më shumë se të tjerat, si në importe ashtu edhe në eksporte, përgjatë dhjetëvjeçarit të fundit.




Figura2: Tregtia e jashtme e Shqipërisë me vendet e rajonit 2006-2016 (Leara, 2015)

Nga ky grafik arrijmë në përfundim se pavarësisht ritmeve të larta të rritjes së tregtisë, Shqipëria ashtu si dhe dhjetë vite më parë, vazhdon të ketë një bilanc negativ tregtar me rajonin dhe çdo vend të tij, me përjashtim të Kosovës. Niveli i mbulimit të importeve nga eksportet në rajon arriti në 80.1% në vitin 2016, nga 42.6% që ky raport ishte në vitin 2006.

Kosova është i vetmi partner tregtar në rajon, me të cilin Shqipëria gjatë viteve të fundit ka një bilanc tregtar pozitiv. Kështu në vitin 2016, eksportet përbëjnë 74% të tregtisë me Kosovën dhe mbulimi i importeve nga eksportet në Kosovë është në nivelin 285%, nga 208% që i njëjti tregues ishte në vitin 2006. Por më i rëndësishëm është fakti se tregtia mes dy shteteve shqiptare është mbi pesëfishuar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, nga rreth 30 milionë euro gjatë 2006, në 165 milionë euro në 2016 (theksojmë se tregtia me Kosovën arriti vlerën më të lartë në vitin 2015, me 194 milionë euro).




Figura3: Ecuria e importeve dhe eksporteve dhe pesha e tregtisë me Kosovën, si pjesë e tregtisë me rajonin 2006-2016(Learata, 2015)

Prej të dhënave të pasqyruara në grafik vihet re se rritja e tregtisë me Kosovën ka qenë më e lartë deri në vitet 2012-2013 dhe pas kësaj periudhe, importet nga Kosova kanë pasur rritje modeste ndërsa eksportet kanë pësuar edhe ulje, duke shënuar vlerën e tyre më të lartë në vitin 2015. Si rezultat i këtij ngadalësimi gjatë 3-4 viteve të fundit, pesha relative që tregtia me Kosovën zë në tregtinë e Shqipërisë me vendet e rajonit, ka ardhur gradualisht në ulje, prej kulmit 32.5% arritur në vitin 2013, në 28% të tregtisë me rajonin gjatë vitit 2016.

Nën të njëjtin këndvështrim, për shkak të nivelit ende të ulët të zhvillimit të Shqipërisë dhe Kosovës, kufizimet në tregti burojnë edhe prej mundësive të kufizuara që bizneset e të dy

vendeve mund t'i ofrojnë njeri-tjetrit, në kushtet kur kërkesa për produkte mund plotësohet në kushte më konkurruese prej vendeve të tjera. Edhe sikur kufiri të mos ekzistojë, si Shqipëria, ashtu dhe Kosova do të jenë të varura nga shkëmbimet tregtare me vendet e tjera, pasi ekonomitë nuk mundën që të plotësojnë nevojat e njëra-tjetrës për pjesën dërrmuese të produkteve të tregtuara. Kjo vihet re edhe po të shohim strukturën e importit dhe eksportit drejt Kosovës gjatë viteve të fundit. Pra jo vetëm cilët janë produktet më të shkëmbyer, por dhe cilët janë produktet më të orientuar në tregti me Kosovën, krahasuar kjo në mënyrë relative me partnerët e tjerë tregtarë të Shqipërisë.




Figura4: Përqendrimi i eksporteve në tregtinë me Kosovën sipas produkteve –2016(Leara, 2015)

Një analizë e tillë tregon se ka eksporte të Shqipërisë të cilat janë së tepërmi të orientuara drejt tregut të Kosovës, si tapat e shisheve (të cilat eksportohen plotësisht vetëm në Kosovë), gjithashtu produkte ushqimore, kimikatet etj., por vlera e tyre është realisht e vogël. Produktet me vlerë më të konsiderueshme rezultojnë vajrat dhe bojërat, eksportet drejt Kosovës së të cilave përbëjnë respektivisht 85% dhe 52% të eksportit total të Shqipërisë në këto produkte.

Analiza e importeve tregon se shkalla e ‘varësisë’ nga tregu i Kosovës është shumë më e ulët. Të vetmet importe të konsiderueshme janë mielli, zarzavatet dhe pijet, të cilat zënë respektivisht 22%, 15% dhe 9.5% të importit total të Shqipërisë për secilin produkt. Kjo analizë në nivel produktesh dëshmon se shkalla e specializimit të ekonomive në produkte që i shërbejnë tregut të dy vendeve është shumë e kufizuar.




Figura5: Përqendrimi i importeve në tregtinë me Kosovën – 2016 (Learta, 2015)

Edhe në këtë grafik një rezultat i ngjashëm del edhe nga analiza e shkëmbimeve tregtare të Kosovës me Shqipërinë. Dallimi kryesor lidhet me faktin se tregtia mes dy shteteve rezulton më e rëndësishme për Kosovën se në rastin e Shqipërisë, fakt që shpjegohet me orientimin më të madh të tregtisë së Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian dhe përmasave të ndryshme të ekonomive të dy vendeve. Kështu importet nga Shqipëria përbëjnë 6% të importeve të Kosovës, ndërsa eksportet drejt Shqipërisë mbi 12% të eksporteve të Kosovës gjatë vitit 2015.

Të dhënat e mësipërme tregojnë kufizimet që ekzistojnë në tregtinë Shqipëri-Kosovë, por njëkohësisht ato tregojnë edhe potencialin ende të pashfrytëzuar të përfitimeve që burojnë prej këtij bashkëpunimi, i cili për produkte të caktuara ka ardhur duke u konsoliduar ndër vite, duke thelluar aktivitetin ekonomik në të dy vendet.




Figura6: Tregtia e Kosovës me Shqipërinë dhe pesha e saj në tregtinë me jashtë të Kosovës(Leartha, 2015)

Nga ky grafik shohim se një element tjetër që duhet përmendur si faktor ndikues në tregtinë midis Shqipërisë e Kosovës lidhet me traditën historike të funksionimit dhe shkallën e inercisë së kanaleve të tregtisë, të cilat kërkojnë kohën e nevojshme për t’u riorientuar drejt mundësive të reja ne treg. Është pikërisht ky faktor që mban Shqipërinë në vazhdimësi të hapur drejt tregut evropian, ndaj të cilit Shqipëria është nisur të orientohet që në fillim të viteve 90’, sikurse edhe Kosovën ndaj vendeve të tjera të rajonit, për shkak të marrëdhënieve historike tregtare me këto vende.

Fakti që shkëmbimet tregtare mes Shqipërisë e Kosovës dominohen nga produktet e ‘rënda’ dhe me vlerë të shtuar të ulët reflektohet jo vetëm në shifrat e importeve dhe eksporteve, por edhe në vlerën reale të tyre. Të dhënat e disponueshme na tregojnë se vlera mesatare për 1 ton mall që qarkulloi në Bashkimin Evropian gjatë vitit 2016 ishte 1,732 euro, ndërkohë që i njëjti tregues për tregtinë mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është 1,147euro dhe për tregtinë mes Shqipërisë dhe Kosovës vetëm 171 euro.Së fundmi, nuk mund të mohojmë se edhe pse mjaft përparim është arritur në lehtësimin e tregtisë midis

Shqipërisë dhe Kosovës, situata mbetet ende larg asaj ideale. Bizneset e të dy anëve të kufirit shqiptar ankohen vazhdimisht për pengesat e ndryshme administrative, infrastrukturore, të kostove të panevojshme për të kryer tregti apo dhe masave mbrojtëse, shoqëruar me ekzistencën e ekonomive të karakterizuara nga pozicione oligopoliste apo monopoliste në treg, faktorë të cilët së bashku dëmtojnë edhe më tej mundësitë e kufizuara që ekzistojnë për tregti midis dy vendeve.




Figura7: Vlera mesatare e mallrave të shkëmbyera Brenda BE dhe midis Shqipërisë, BE dhe vendeve të rajonit(Leartha, 2015)

Ky grafik na tregon gjithashtu të njëjtin tregues në tregtinë me disa vende të tjera të rajonit dhe na shpjegon ngarkesën e Rrugës së Kombit me makina të rënda transporti që qarkullojnë përgjithësisht skrap, hekur, çimento apo produkte të tjera me vlerë të shtuar të ulët, gjë që shtyn nevojën e ndërtimit të politikave të përbashkëta për ndërtimin e fuqizimin e industrive shumë më produktive dhe konkurruese në tregun e përbashkët.

Rezultati B

Përgjatë analizimit të literaturës të shqyrtuar të dhënave sekondare, i gjithë ky rezultat me pyetjen:

Si do të ndikonte në ekonominë e të dyja shteteve, nëse do të rritej bashkëpunimi ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës?

Rezulton në përputhje me HO- hipotezën negative. Të dyja shtetet duhet të bashkëpunojnë me vende më të zhvilluara dhe jo ndërmjet vete për të rritur zhvillimin ekonomik.

KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Marrëdhëniet midis Kosovës dhe Shqipërisë mund të përmirësohen më tej në shumë fusha. Marrëveshja për partneritetin strategjik midis të dy vendeve përbën një moment të rëndësishëm në konsolidimin e lidhjeve të ndërsjellat ekonomike dhe i vendos marrëdhëniet midis dy vendeve në një kornizë ligjore dhe institucionale të konsoliduar. Ekonomia mbetet forca më e rëndësishme lëvizëse në marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë dhe në këtë drejtim marrëveshjet për lehtësimin e nxitjen e tregtisë, padyshim që do të kenë ndikimin e tyre pozitiv në forcimin e lidhjeve të ndërsjellat ekonomike. Megjithatë, është e nevojshme që të ndërmerren hapa të tjerë në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara. Politikat e përbashkëta për përafrimin e legjislacionit administrativ dhe tregtar, dhe më e rëndësishmja një strategji të re për orientimin drejt zhvillimit të përbashkët të qëndrueshëm për ekonomitë e dy vendeve janë çështje thelbësore që duhet të adresohen në të ardhmen. Një agjendë e përbashkët për rigjallërimin e industrisë prodhuese dhe politika të përbashkëta në lidhje me energjinë dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, janë të gjitha iniciativa që mund të sjellin përfitime për ekonomitë e të dy vendeve. Për më tepër, takimet e ardhshme të përbashkëta në mes të dy qeverive duhet të ketë një agjendë të detajuar dhe konkrete në të gjitha fushat që prekin marrëdhëniet reciproke dhe ato nuk duhet të përdoren për arsye nacionaliste. Në këtë kapitull janë përmbledhur pikat kryesore nga i gjithë punimi për të shpjeguar më mirë pyetjen hulumtuese.

Tani është e qartë se ndërmarrësit e Kosovës, qoftë ata vendorë apo ndërkombëtarë, tregojnë relativisht pak interesim në investime në sfera të reja. Në vend të gjurmimit të mundësive të reja për investim, investorët në Kosovë janë përqendruar në sektorët tradicionalë dhe janë duke e gjymtuar fitimin e njëri-tjetrit. Në aktivitetet ekzistuese (tradicionale) konkurrenca është e fortë. Sidoqoftë, me lidhje të forta me botën perëndimore, që janë themeluar nga mijëra emigrantë kosovarë, veçanërisht në Gjermani dhe Zvicër, nuk duhet të ketë mungesë të madhe të shkathtësive ndërmarrëse.

Në bazë të analizimit të bashkëpunimi ekonomik në mes Kosovës dhe Shqipërisë gjatë viteve 2006-2016 arrijmë në përfundim se edhe sikur kufiri të mos ekzistonte, si Shqipëria ashtu dhe Kosova do të jenë të varura nga shkëmbimet tregtare me vendet e tjera, pasi ekonomitë nuk mundën që të plotësojnë nevojat e njëra-tjetrës për pjesën dërrmuese të produkteve të tregtuara. Produktet që i shërbejnë tregut të dy vendeve është shumë e kufizuar. Kufizimet në tregti burojnë edhe prej mundësive të kufizuara që bizneset e të dy vendeve mund t'i ofrojnë njëra-tjetrës. Një faktor tjetër lidhet me traditën historike në mes Kosovës dhe Shqipërisë të funksionimit dhe shkallën e inercisë së kanaleve të tregtisë, të cilat kërkojnë kohën e nevojshme për t'u riorientuar drejt mundësive të reja në treg. Përgjatë këtij punimi rreth analizimit të këtyre dy shteteve është vërejtur se këto të dyja kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të njëra-tjetrës, por mënyra më e mirë për të rritur zhvillimin ekonomik të dy shteteve është të orientohen drejt tregut evropian, të bashkëpunojnë me shtete më të zhvilluara ekonomikisht.

Kosova dhe Shqipëria si dy shtete të pavarura në rajon, nuk mund të konsiderohen vende fqinje në nivel të njëjtë se si ata do të konsideroheshin përballë vendeve të tjera fqinje. Këto dy shtete shquhen për një seri karakteristikash të përbashkëta si dhe për zhvillime të rëndësishme e të përbashkëta historike. Përkundër kësaj, ato vazhdojnë të hasin në vështirësi në drejtim të zhvillimit më të hovshëm dhe të normalizuar të marrëdhënieve tregtare bilaterale. Përderisa vërehet një numër i madh i bashkëpunimeve të suksesshme në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në fushat e politikës dhe të kulturës, e njëjta gjë nuk mund të thuhet edhe për fushën e ekonomisë. Të dy vendet, që nga pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës kanë përjetuar një rritje të fluksit tregtar me njëra tjetrën, mirëpo ajo çka është brengosëse në këtë mes, është fakti që kualiteti dhe vlera e shkëmbimeve tregtare është shumë e ultë dhe e një kualiteti jo të kënaqshëm, duke u bazuar në produkte bazike dhe materiale të papërpunuara pa ndonjë vlerë të shtuar të theksuar. Kjo ndodhë kryesisht për disa arsye, ku ndër më të dalluarat janë mungesa e zhvillimit të brendshëm ekonomik dhe niveli i ulët i prodhimit dhe si rrjedhojë oferta jo e pasur që mund t'i servojnë këto vende njëra tjetrës.

Rekomandime

Me qëllim kontributin e forcimit e mëtejshëm të marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Kosovës, jepen disa rekomandime si më poshtë:

- ❖ Të bëhet eliminimi i të gjitha barrierave jo-tarifore që pengojnë marrëdhëniet tregtare mes dy vendeve.
- ❖ Të vihen në zbatim të gjitha marrëveshjeve ekonomike të nënshkruara.
- ❖ Të realizohen hapa të mëtejshëm në përafrimin dhe harmonizimin e legjislacionit tregtar, të punës dhe atë bankar midis Kosovës dhe Shqipërisë.
- ❖ Të krijohen strategji afatgjatë për krijimin e një zone të përbashkët ekonomike plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe politikat ekonomike rajonale.
- ❖ Politikat e përbashkëta për promovimin e industrive prodhuese me qëllim ringjalljen e industrisë prodhuese, duke shfrytëzuar bashkërisht burimet më të rëndësishme natyrore të Kosovës dhe Shqipërisë.
- ❖ Investime të përbashkëta në projekte të përbashkëta të infrastrukturës.
- ❖ Strategji e përbashkët për një turizëm të qëndrueshëm.
- ❖ Ministrinë përkatëse të linjës, në bashkëpunim me agjencitë turistike duhet të ofrojnë paketa të përbashkëta turistike Shqipëri-Kosovë, ku do të përfshihen asetet më të rëndësishme turistike të të dy vendeve.
- ❖ Krijimi i një forumi të përhershëm mediatik me pjesëmarrjen e aktorëve të medieve dhe përfaqësuesve të institucioneve përkatëse shtetërore me qëllim hartimin e një strategjie dhe një plani të përbashkët të veprimit për një partneritet të ri mediatik Shqipëri-Kosovë.
- ❖ Politika të përbashkëta që do të synonin krijimin e një sistemi të unifikuar arsimor për të dy vendet. Bashkimi i Akademive të Shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës në një akademi të unifikuar për hartimin e mëtejshëm të politikave të përbashkëta arsimore dhe zhvillimin e përbashkët të gjuhës letrare shqipe.

REFERNCAT

- Acit. (2020). *Integrimi ekonomik dhe tregtar i Shqipërisë dhe Kosovës*. Dy shtete një ekonomi, 1-56. Marrë më: 24 Shkurt, 2020, nga:
[https://www.osfa.al/sites/default/files/acit_studimi - tregtia shqiperi kosove_shkurt_2020_kendveshtrimi_i_shqiperise.pdf](https://www.osfa.al/sites/default/files/acit_studimi_-_tregtia_shqiperi_kosove_shkurt_2020_kendveshtrimi_i_shqiperise.pdf)
- Altax. (2015). *Rritja ekonomike në Shqipëri*: Faktorët ndikuesë dje, sot dhe nesër. Marrë më: 22 Shkurt, 2020, nga: <https://www.altax.al/al/blog-al/417-rritja-ekonomike-ne-shqiperi-faktoret-ndikuese-dje-sot-dhe-neser>
- Hollaj, L. (2015). Marrëdhëniet tregtare Kosovë - Shqipëri. *Indep* , 1-30.
- Kenton, W. (2009). *Economy*. Investopedia , 2.
- Kryeziu, L. C. (2018). *Political and Economic Institutions and Economic Performance: Evidence from Kosovo*. ResearchGate .
- Kukaj, Q. (2006). Wikipedia. *Ekonomia e Kosoves*. Marrë më:18 Shkurt, 2020, nga: <http://www.wikipedia.com>
- Kushnir, I. (2019). *Economy of Kosovo*. Beograd: Independently.
- Learta, H. (2015). Marrëdhëniet ekonomike të shteteve fqinje. Tirana: Instituti për Politika Zhvillimore.
- Mançellari, A. (2012). *Ekonomiksi*. Tiranë: albPAPER.
- Palmer, N. T. (2012). *The Importance of Economic Growth*. 3.
- Qirici, S. H. (2002). *Hyrje në ekonomi*. Tirane: Pegi.
- Rexhepi, I. (2013). *Panorama*. Për një ekonomi të përbashkët. Marrë më: 19 Shkurt, 2020, nga;: <http://www.panorama.com>
- RIINVEST. (2005). *Qendrueshmeria ekonomike ne Kosove*. Instituti per hulumtime zhvillimore . Marrë më: 28 Shkurt, 2020, nga:
<https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476703303.pdf>
- Stickney, E. P. (2018). *Economy of Albania*. Columbia: University Press. Ekonomia e

Kosoves. (2019). Marrë më: 19 Shkurt, 2020, nga:

<https://www.meiks.net/sq/kosova/ekonomia-e-kosoves>